

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6193  
E enjte, 17 dhjetor 2020  
çmimi 0.40 €

Për masat e reja kundër Covidit vendoset të premten FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NË PRITJE TË TRYEZËS SË PARTIVE POLITIKE PËR ZGJIDHJEN E PRESIDENTIT TË RI TË KOSOVËS FAQE 4-5

## ANALISTËT PËR POZITËN E PRESIDENTIT: PARTITË POLITIKE PO SHANTAZHOJNË NJËRA-TJETRËN



Partitë politike parlamentare janë të betonuara në pozicionet e tyre lidhur me zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Pavarësisht prej paralajmërimeve për një tryezë të të gjitha partive, një gjë e tillë nuk po ndodh. Ndërkaq njohësit e zhvillimeve politike në vend kanë thënë se sa herë që vjen koha për zgjedhjen e presidentit, krizat politike ia zënë vendin njëra-tjetrës. Sipas tyre, partitë politike për çështjen e pozitës të presidentit po vazhdojnë ta shantazhojnë njëra-tjetrën

## MË 25 JANAR MBAHET MBLEDHJA E PËRBASHKËT QEVERTARE KOSOVË - MAQEDONI FAQE 3

Më 25 janar të vitit të ardhshëm, në Shkup, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë së Veriut do ta mbajnë mbledhjen e përbashkët qeveritare. Për organizimin e kësaj mbledhje të përbashkët, zëvendëskryeministrja e

Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka qëndruar të mërkurën në Shkup, ku është takuar me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi. Balaj-Halimaj ka bërë me dije se janë duke punuar që më 25 janar të nënshkruhet

marrëveshja për një pikë të përbashkët kufitare, po ashtu do të ketë një marrëveshje për studim të fizibilitetit të rrugës Prizren - Tetovë si dhe marrëveshje të tjera në fushën e arsimit, kulturës, rinisë dhe turizmit



## SELMANAJ: PO U VJEN FUNDI DEMBELËVE BRENDA SISTEMIT TË DREJTËSISË FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

NARRACION PËRMBYSËS F. 11

Shkruan:  
Agron HOTI



### AKTUALE



OSBE-ja NDIHMOM GAZETARËT ME MJETE MBROJTËSE, XHAKETA DHE JELEKË F. 6

OSMANI BËRI HOMAZHE TE MEMORIALI I SKËNDERBEUT NË LEZHË F. 3

### EKONOMI

KOSOVA DHE SERBIA PËRPLASEN NË TAKIMIN VIRTUAL TË CEFTA-S F. 8

BORDI I POSTËS HARMONIZON PAGAT SIPAS GRADAVE NGA 8 DERI NË 17 F. 8



### KULTURË

ISA QOSJA DHE NORIKA SEFA, PJESË E FIRST CUT+ F. 6



## Osmani bëri homazhe te Memoriali i Skënderbeut në Lezhë

LEZHË, 16 DHJETOR (ER) - U. d. presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nisur një vizitë treditore në Shqipëri me një homazh te memoriali i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në Lezhë. Ajo tha se nisja e vizitës me homazh te varri i heroit kombëtar është në funksion të rikujtimit të strategut që bëri shumë për projektin integruar

mesjetar, duke u shndërruar në fortifikatë të civilizimit perëndimor.

Sipas saj, figura e Skënderbeut duhet të shërbejë si model i bashkimit në kohë të trazuara si kjo e sotmja. "Ai bëri atë që na duhet më së shumti sot. Përveç që ishte gardian i vlerave të qytetërimit perëndimor, ishte edhe model i unifikimit. Ai

dikur mbrojti vlerat e qytetërimit, të cilin e synojnë bashkë Kosova e Shqipëria", ka theksuar Osmani. Ajo tha se figura e Skënderbeut është e përbotshme, siç janë Kosova dhe Shqipëria, të cilat, pavarësisht prej sfidave dhe pengesave, në një të ardhme do të jenë pjesë e familjes së madhe evropiane.



## Bideni emëron ish-rivalin sekretar të Transportit



UASHINGTON, 16 DHJETOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka emëruar ish-kandidatin demokrat për president, Pete Buttigieg, sekretar të Transportit. Buttigieg është ish-rivali i parë i Bidenit që emërohet në një pozitë të lartë në kabinet. Ai, po ashtu, do të bëjë histori si sekretari i parë që deklarohet hapur se është homoseksual. Buttigieg, 38 vjeç, është veteran i Marinës amerikane, që ka shërbyer oficer rezervist i inteligjencës në Afganistan

në vitin 2014.

Emërimi i tij për sekretar të Transportit u vlerësua nga grupet për të drejtat e homoseksualëve. Fushata e të Drejtave të Njeriut tha se Buttigieg "ka qenë i hapur dhe i sinqertë" për identitetin e tij dhe se i ka dhënë zë komunitetit.

Buttigieg ka garuar për nominimin e Partisë Demokratike si kandidat për zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit. Pasi ka rënë nga gara, ai ka mbështetur Bidenin.

## Von der Leyen: Ditët e ardhshme, vendimtare për BE-në dhe Britaninë

BRUKSEL, 16 DHJETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se nuk mund ta thotë me siguri se do të ketë marrëveshje tregtare me Britaninë, por ka shtuar se në ditët e fundit ka pasur përparim në bisedime. "Ashtu siç qëndrojnë gjërat tani, nuk mund të them nëse do të ketë marrëveshje ose jo. Por, mund të them se tani ka një rrugë drejt marrëveshjes. Rruga është shumë e ngushtë por, ekziston. Kemi gjetur një rrugë përpara në shumicën e çështjeve, por dy prej tyre mbeten ende pengesë: fusha e barabartë e veprimit dhe peshkimi. Ditët e ardhshme do të jenë vendimtare", ka deklaruar ajo në Parlamentin Evropian. Britania dhe BE-ja janë në ditët e fundit të negociatave për ta mbrojtur tregtinë e lirë, në vlerë

prej 1 trilion dollarësh, pas 31 dhjetorit, kur Britaninë e përfundon periudha e tranzicionit, pas daljes nga BE-ja. Britania ka dalë nga BE-ja më 31 janar, por ka vazhduar tregtinë me bllokun nën të njëjtat kushte. Dështimi për të arritur marrëveshje para 31 dhjetorit mund të krijojë kaos në kufij për shkak të tarifave dhe masave të tjera.

Ky skenar do t'i lëkundte tregjet financiare dhe zinxhirët e furnizimit në të gjithë Evropën. Von der Leyen ka pohuar se diskutimet për hyrjen e anijeve të BE-së në ujërat e peshkimit në Mbretërinë e Bashkuar janë "ende shumë të vështira" por, sipas saj, negociatorët kanë ecur përpara në një element tjetër të diskutueshëm - konkurrencën e ndershme.



## Bledi Çuçi emërohet ministër i Brendshëm në Shqipëri

TIRANË, 16 DHJETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka caktuar Bledi Çuçin ministër të Punëve të Brendshme, ndërsa Milva Ikonomi do të jetë ministre Bujqësisë. Lajmin e ka

dhënë Rama nëpërmjet llogarisë se vet në "Facebook". "Sot do të dërgoj për dekretim nga Presidenti, Bledi Çuçin si ministër i Brendshëm dhe Milva Ikonomin si ministre

Bujqësie, dy bashkëpunëtorë të përkushtuar në çdo detyrë që kanë kryer këto vite, me integritet, profesionalizëm dhe kulturë qytetare e politike të padyshimtë", ka shkruar Rama.

Çuçi është emëruar në këtë pozitë pas dorëheqjes së Sandër Lleshajt nga pozita e ministrit të Brendshëm. Dorëheqja e tij ka ndodhur pas vrasjes së Klodian Rashës nga një polic.

# Më 25 janar mbahet mbledhja e përbashkët qeveritare Kosovë - Maqedoni

Më 25 janar të vitit të ardhshëm, në Shkup, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë së Veriut do ta mbajnë mbledhjen e përbashkët qeveritare. Për organizimin e kësaj mbledhje të përbashkët, zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka qëndruar të mërkurën në Shkup, ku është takuar me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi. Balaj-Halimaj ka bërë me dije se janë duke punuar që më 25 janar të nënshkruhet marrëveshja për një pikë të përbashkët kufitare, po ashtu do të ketë një marrëveshje për studim fizibiliteti të rrugës Prizren - Tetovë, si dhe marrëveshje të tjera në fushën e arsimit, kulturës, rinisë dhe turizmit



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**SHKUP, 16 DHJETOR** - Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Maqedoninë e Veriut. Ajo është takuar me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, me të cilin kanë biseduar për organizimin e mbledhjes së përbashkët ndërmjet dy qeverive, e cila do të mbahet më 25 janar të vitit të ardhshëm në Shkup. "Sapo përfunduar një

takim jashtëzakonisht përmbajtësor në Shkup, me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, me të cilin biseduam për organizimin e mbledhjes së përbashkët ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të mbahet më 25 janar të vitit të ardhshëm në Shkup", shkruar Balaj-Halimaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ajo ka bërë me dije se bashkërisht janë marrë vesh për një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve që do të nënshkruhen në këtë mbledhje, nga të cilat do të përfitojnë

qytetarët e dy vendeve dhe bizneset. "Po punojmë shumë që më 25 janar të nënshkruhet në mënyrë solemne marrëveshja për një pikë të përbashkët kufitare. Po ashtu, do të ketë një marrëveshje

për studim të fizibilitetit të rrugës Prizren - Tetovë, si dhe marrëveshje të tjera në fushën e arsimit, kulturës, rinisë dhe turizmit. Jam jashtëzakonisht e kënaqur që në Qeverinë e

Maqedonisë së Veriut ekziston vullnet shumë i madh për të bashkëpunuar me Kosovën si dy vende fqinje", ka bërë me dije zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj.

## Masat e reja anti-Covid pritet të finalizohen të premtën

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 16 DHJETOR** - Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije të mërkurën se do të mbledhet së bashku me ekspertë shëndetësorë dhe deri të premtën do të dalin me masa të reja anti-Covid. "Ka tre apo katër ditë që jemi duke diskutuar për masat. Besoj se deri të premtën do ta përfundojmë këtë diskutim. Këto masa jemi duke i diskutuar në bazë të rekomandimeve të ekspertëve dhe organizatave ndërkombëtare. Jemi duke parë se çfarë përvoja kanë vendet e tjera. Nuk mund të them tash se çfarë masa do të marrim për qarkullim dhe për qytetarët nga diaspora, por po them se deri të premtën i finalizojmë konsultimet", ka thënë Hoti në një konferencë për media. Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin

Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 158 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 296 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të personave të vdekur nga ky virus. Rastet e të vdekurve janë nga: komuna Prishtinë një rast (79 vjeç), Rahovec një rast (58 vjeç), Lipjan një rast (78 vjeç), Klinë një rast (63 vjeç) dhe Viti një rast (65 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 47 499 raste nga 166 741 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 225 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 319 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 34 956 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 318. Rastet pozitive janë nga:



komuna Prishtinë 139 raste, Podujevë 25 rast, Fushë-Kosovë 19 raste, Gjakovë 16 raste, Lipjan 16 raste, Drenas 14 raste,

Mitrovicë 13 raste, Gjilan 12 raste, Ferizaj 10 raste, Rahovec 6 raste, Vushtrri 5 raste, Obiliq 4 raste, Klinë 3 raste, Skenderaj 3

raste, Viti 3 raste, Prizren 2 raste, Kamenicë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Graçanicë, Ranillug, Shtime dhe Suharekë.



NË PRITJE TË TRYEZËS SË PARTIVE POLITIKE PËR ZGJIDHJEN E PRESIDENTIT TË RI TË KOSOVËS

# ANALISTËT PËR POZITËN E PRESIDENTIT: PARTITË POLITIKE PO SHANTAZHOJNË NJËRA-TJETRËN

Partitë politike parlamentare janë të betonuara në pozicionet e tyre lidhur me zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Pavarësisht prej paralajmërimeve për një tryezë të të gjitha partive, një gjë e tillë nuk po ndodh. Ndërkaq njohësit e zhvillimeve politike në vend kanë thënë se sa herë që vjen koha për zgjedhjen e presidentit, krizat politike ia zënë vendin njëra-tjetrës. Sipas tyre, partitë politike për çështjen e pozitës të presidentit po vazhdojnë ta shantazhojnë njëra-tjetrën

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Partitë politike parlamentare aktualisht janë të betonuara në pozicionet e tyre lidhur me çështjen e zgjedhjes së presidentit të ri të Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka paralajmëruar se do t'i thërrasë partitë e tjera parlamentare në një tryezë për të diskutuar për çështjen e zgjedhjes së presidentit të ri, por

një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila është pjesë e koalicionit aktual qeverisës, ka propozuar liderin e saj Ramush Haradinaj për pozitën e presidentit dhe po vazhdon të këmbëngulë në propozimin e saj.

E përfaqësues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë pohuar se deputetët e kësaj partie nuk do ta votojnë asnjë kandidat për president

nga radhët e partive të koalicionit qeverisës. Sipas zyrtarëve të PDK-së, në rast se i kërkohen votat për presidentin e ri, atëherë ai duhet të jetë i propozuari i saj. Kurse Lëvizja Vetëvendosje vazhdon të këmbëngulë që vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja, tek pastaj të zgjedhet presidenti i vendit.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kjo parti nuk e ka asnjë problem që të shkojë në

zgjedhje të reja, por nuk sheh që zgjedhjet ofrojnë zgjedhje për presidentin. Për këtë temë kanë folur edhe njohës të zhvillimeve politike në vend, të cilët kanë përkrahur idenë që presidenti të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët për t'u ikur bllokadave që po bëjnë partitë politike rreth kësaj pozite.

Profesori universitar Valon Murati ka thënë se sa herë që vjen koha për zgjedhjen e presidentit me të drejtë opinioni publik shqetësohet, sepse krizat politike ia zënë vendin njëra-tjetrës dhe ndonjëherë nuk janë të mjaftueshme as zgjedhjet e reja. Murati ka thënë se partitë politike për këtë çështje po vazhdojnë ta shantazhojnë njëra-tjetrën.

Ai ka folur edhe për mundësinë që presidenti të zgjedhet

drejtpërdrejt nga qytetarët, duke paraqitur edhe vështirësitë në këtë proces. "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, se në dy herët e para të votimit duhet të jenë të pranishëm 80 deputetë (pra 2/3 e deputetëve), aq sa duhen për ta zgjedhur presidentin, e bën këtë një mision shumë të vështirë për Kuvendin tonë që për asgjë nuk krijon konsensus. Partitë politike vazhdojnë ta shantazhojnë njëra-tjetrën. Realisht shantazhojnë Kosovën dhe funksionalitetin e shtetit tonë. Rrjedhimisht, në diskursin publik fillon me të drejtë kërkohet që presidenti të zgjedhet me votat e qytetarëve të Kosovës. Personalisht jam për një variant të tillë, duke qenë se me Kushtetutën tonë presidenti ka mjaft fuqi dhe nuk do të

kishte nevojë t'i shtoheshin përgjegjësitë. Sidoqoftë, për një zgjidhje të tillë politike duhen ndryshime kushtetuese. Andaj habitem me shumë miq të mi të cilët vazhdojnë të propozojnë këtë zgjidhje, pa diskutuar për vështirësinë e ndryshimeve kushtetuese. Ndryshimet kushtetuese kërkojnë jo vetëm 2/3 e gjithë deputetëve, por edhe 2/3 e deputetëve të pakicave, që nënkupton së paku katër deputetë nga Lista Serbe duhet të votojnë për ndryshimet kushtetuese, me ç'rast do t'ia zvogëlonin peshën votës së tyre (serbe) për zgjedhjen e presidentit", ka thënë ai.

Njohësi i çështjeve juridike dhe kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka thënë se në afatet kushtetuese që jemi nuk mund të zgjedhet një president drejtpërdrejt nga qytetarët. Edhe Baraliu ka thënë se në këtë drejtim do të jetë pengesë bllokada që është krijuar me Kushtetutën e Ahtisarit ku, pos 2/3-tave, kërkohej edhe shumica e deputetëve pakicë dhe, sipas tij, ndryshimet

kushtetuese hëpërhë janë të pamundshme. "Në afatet kushtetuese që jemi, kur për ushtrim të detyrës së presidentit është kryetarja e Kuvendit të Kosovës, afati është shumë i ngushtë dhe po ngushtohet gjithnjë e më tepër. Pra, po flas në këtë gjashtëmujorin maksimal që të kemi mundësi dhe hapësirë për ndryshimet kushtetuese. Është e domosdoshme që të kemi një harmonizim të qëndrimeve të kësaj klase politike, të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, sepse kohë nuk kemi shumë. Edhe po të kishim, ne e kemi sjell vendin në atë gjendje që jemi të bllokuar me Kushtetutën e Ahtisarit, e cila pothuajse është e pamundur të krijojë zgjidhje. Duhet shumica e deputetëve, 2/3-tat, dhe shumica e deputetëve pakicë. Pra, shumica e ashtuquajtur e Badinterit. Për këtë punë Lista Serbe, por edhe komunitetet pakicë për çështjet që atyre u interesojnë, mund ta pranojnë një zgjidhje, por për interesat e shtetit dhe popullsisë që janë

në interesin tonë, në këtë rast zgjedhja e presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk u intereson, e nuk mund të kemi ndryshim", ka thënë ai.

Baraliu ka thënë se jemi në një situatë të pamundësisë për ndonjë zgjidhje tjetër. "Zgjidhja e vetme është që partitë politike dhe koalicioni qeverisës të merren vesh për një president konsensual, pastaj të shkohet në zgjedhje të reja. Ose varianti tjetër, nëse nuk merren vesh vetëm për pakon e presidentit, atëherë të merren vesh për të dyja paketat: zgjedhjen e presidentit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Në këtë variant të fundit do të pajtoheshin të gjitha partitë kur në marrëveshje hyn edhe çështja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat do të duhej të mbaheshin në një afat optimal, në muajin mars ose prill të vitit të ardhshëm", ka thënë Baraliu.

Analisti politik Ramush Tahiri ka thënë se partitë politike po bëjnë politikë me këtë çështje duke e kushtëzuar njëra-

tjetrën. "Pretendimet e partive për këtë post politik janë të natyrshme. Pavarësisht se kush pretendon këtë post, Kushtetuta thotë se kandidatët për president duhet t'i kenë nga 30 nënshkrime të deputetëve. As Ramush Haradinaj dhe askush tjetër nuk e ka nisur procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve për të qenë kandidat për president. Pra, sipas Kushtetutës, duhet të jenë dy kandidatë për president dhe ata duhet t'i kenë nga 30 nënshkrime. Tash partitë politike po bëjnë politikë me këtë çështje duke e kushtëzuar njëra-tjetrën", ka thënë ai.

Tahiri ka thënë se në bazë të gjendjes aktuale, presidenti duhet të zgjedhet prej LV-së ose prej PDK-së. "Siç e dimë, LV-ja është e interesuar të shkojë në zgjedhje, kurse PDK-ja dëshiron ta këtë kandidatin e vet, pastaj të shkohet në zgjedhje", ka deklaruar Tahiri.

Ndaj situatës së fundit, zgjedhjes së presidentit, ka reaguar edhe profesori universitar, publicisti Muhamet

Mavraj. Ai në një shënim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se presidenti duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët, pastaj edhe kryeministri. "Kryetari duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Pastaj edhe kryeministri. Të përshtatet Kushtetuta. Ka mjaft kohë. Disa kombe bëjnë kështu. U bëjmë horë për asgjë: Për gjashtë vjet, pesë kryeministra! Nëse dëshirojnë për kryetarin, i gjashti kryeministër në pranverë. Me këta liderë egoistë, po perceptohemi si shtet i dështuar", ka thënë Mavraj.

Zgjedhja e presidentit të ri të Kosovës, pas dorëheqjes së Hashim Thaçit nga kjo pozitë më 5 nëntor, pasi Dhoma e Specializuar në Hagë, konfirmuan aktakuzën ndaj tij për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, tashmë është e domosdoshme. Aktualisht pozitën e presidentit është duke e ushtuar kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani.

## Bursistët nga skema e profesionistëve të rinj punësohen në institucione shtetërore



PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agim Veliu, bashkë me kryeministrin Avdullah Hoti dhe shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, mbajtën ceremoninë e dhënies së aktemërimeve për bursistët nga Skema e Profesionistëve të Rinj. Me këtë rast, ministri Veliu tha se Projekti i Skemës së Profesionistëve të Rinj është një ndër projektet më të

suksesshme të Bashkimit Evropian në Kosovë. "Ishte kënaqësi t'u uroj mirëseardhje të gjithë bursistëve që sot do të sistemohen në institucionet e përzgjedhura prej tyre si dhe t'i uroj ta vazhdojnë edhe më tutje karrierën e tyre në shërbimin civil, duke kontribuar për ndërtimin e së ardhmes së ndritur për vendin tonë dhe për integrimin sa më të shpejtë në familjen evropiane", ka theksuar ministri Veliu me këtë rast.

Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se është i bindur që përmes arsimit të këtyre të rinjve do të kontribuohet për përgatitjen e shoqërisë në Kosovës si në aspektin kulturor, të avancimit të sjelljes në shoqëri dhe të avancimit të punës së administratës publike, në përputhje me nevojat që ka Kosova në rrugën e vet të integritimit evropian. Ndërsa shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, duke

theksuar se ndien kënaqësi të marrë pjesë në këtë ceremoni, tha se Bashkimi Evropian është zotuar që të bëhen reale reformat e administratës publike, ku administrata shtetërore të ketë njerëz të duhur, të kemi një shërbim civil, transparent, të mirë dhe se ky shans është shumë i mirë për të rinjtë që dëshirojnë të studiojnë në vendet e BE-së. Përmes këtij projekti janë përkrahur më shumë se 300 të

rinj nga Kosova që t'i kryejnë studimet pasuniversitare në vendet e Bashkimit Evropian dhe si kusht të punojnë për së paku tri vjet në administratën publike të Republikës së Kosovës. Ky projekt do të vazhdojë ta gëzojë mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe në të ardhmen ku janë planifikuar së paku 3 raunde dhe gjithashtu aplikimi për fondet e IPA III.

## Në Qendrën Korrektuese Dubravë të dënuarit po rinovojnë sallën e vizitave familjare

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Në kuadër të aktiviteteve të punës së organizuar nëpër institucione korrektuese, në Qendrën Korrektuese Dubravë të dënuarit po rinovojnë sallën e vizitave familjare. E gjithë puna është duke u kryer nga të dënuarit e pavijoneve gjysmë të hapura dhe po udhëhiqet nga stafi i Qendrës Korrektuese Dubravë, ndërsa në aspektin profesional është duke u

mbikëqyrur nga Divizioni i Inxhinieringut të ShKK-së. Pavarësisht prej situatës së krijuar nga pandemia në vend të dënuarit nuk i kanë ndërprerë aktivitetet e tyre të përditshme andaj, falë punës së tyre, dhoma e vizitave familjare po merr pamje tjetër. Përmes aktiviteteve të tilla ShKK synon të ndikojë në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të burgosur, po ashtu të

racionalizohet edhe buxheti i ShKK-së.

Të dënuarit, përveçse kanë aktivitete të shumta edukative, sportive, zhvillojnë edhe aktivitete të tjera me të cilat po shprehin talentin në punën dhe zanatet e tyre që ata zotërojnë. Puna e të dënuarave brenda institucioneve korrektuese normalizon edhe jetën e tyre të përditshme brenda qendrës korrektuese.



## OSBE-ja ndihmon gazetarët me mjete mbrojtëse, xhaketa dhe jelekë



PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka pranuar donacion mjete mbrojtëse, xhaketa dhe jelekë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë për gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët e mediave në Prishtinë. Në donacionin e siguruar, shpërndarja e të cilit do të fillojë të hënën, bëjnë pjesë: 55 xhaketa, 55 jelekë, 50 veshje mbrojtëse, 50 mburoja fytyre, 180 pako maska, si dhe 180 dezinfektues 100ml.

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës ka bërë me dije se i ka listat e kolegëve që punojnë në terren dhe janë pajisur me mjete mbrojtëse nga donacionet e mëparshme. "Për tërheqjen e pakove të reja, të njëjtët do të njoftohen në ditët në vijim. AGK-ja do ta vazhdojë angazhimin drejt sigurimit të donacioneve të tjera, në mënyrë që kolegëve tanë t'u lehtësohet sadopak puna që po e bëjnë përgjatë pandemisë Covid-19", ka njoftuar AGK-ja.

## Ndahen mirënjohje për vullnetarët e vitit

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministri e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, së bashku me shefin e UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, kanë ndarë mirënjohje për vullnetarët e vitit. Me këtë rast, ministri Dumoshi u shpreh e lumtur që së bashku me shefin e Zyrës së UNICEF-it, Murat Sahin, po ndajnë mirënjohje për vullnetarët e vitit. Ajo, gjithashtu, tha se me UNICEF-in ka bashkëpunim të shkëlqyer dhe e falënderoi Sahinin që po i ndihmon të rinjtë me anë të programeve të shkëlqyera të cilat i dedikohen rinisë së vendit tonë. "Sot është

ditë e veçantë sepse ju kemi juve vullnetarëve këtu. Për ta pasur emrin vullnetar është një humanitet i cili buron nga shpirti për t'i ndihmuar të tjerët. Kosova së bashku me UNICEF-in dhe organizatat e tjera e ka instaluar me udhëzim administrativ këtë rregull për shpërbllimin e punës suaj. Shpërbllimi është, mbase, vetëm një kujdes ndaj punës suaj, por shpirti dhe humanizmi që tregoni dhe shpërfaqni ndaj njerëzve që kanë nevojë, e sidomos këtë vit në këtë kohë pandemie kur jeni angazhuar për t'i ndihmuar të tjerët, do të thotë shumë për ju", ka thënë Dumoshi.

Ministri Dumoshi i inkurajoi



të rinjtë që të bëjnë punë vullnetare dhe tha se e ka nënshkruar projektligjin për rini dhe se beson se ky ligj do të kalojë në qeveri, pastaj edhe në Kuvend dhe me anë të tij puna vullnetare do të njihet si

përvojë e punës. Ndërkaq shefi i UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, e ka përgëzuar ministren Dumoshi për punën dhe angazhimin e saj në fushën e rinisë. Ai ka thënë se kanë të regjistruar 10

mijë vullnetarë, duke shtuar se rinia duhet të jetë lidere për të bërë ndryshime në shoqëri. Vullnetarëve që iu dhanë mirënjohje: Elsa Haxhija, Lea Noberdaliu, Anida Gjurgjiali, Agon Goqi.

## Isa Qosja dhe Norika Sefa, pjesë e First Cut+

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - "The Stork" (Lejleku), nga regjisorja Isa Qosja dhe "Në kërkim të Venerës" nga regjisorja Norika Sefa, janë dy projektet filmike të Kosovës të përzgjedhura nga programi i njohur First Cut+. First Cut+ është një program i ri i krijuar për rritjen e aftësisë konkurruese dhe tregtimit të filmave artistikë që kanë marrë pjesë më parë në First Cut Lab.

Programi është lansuar nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me dy platforma dinamike dhe të njohura të industrisë së filmit: "When East Meets West" në Trieste dhe "Eastern Promises Industry Days" të Festivalit të Filmit Karlovy Vary. 16 projektet pjesëmarrëse do të kenë tri ditë konsultime mbi promovimin, marketingun, mediat, krijimin e trailerave, lansimin në festivale,

strategjinë e shitjeve nga konsulentë të ndryshëm të industrisë së filmit, të ndjekur nga një seancë Works-in-progress të hapur për vendimmarrës (si programues të festivaleve kryesore, blerës, agentë ndërkombëtarë të shitjes etj). Të dy filmat janë të mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës dhe pritet të shfaqen së shpejti për publikun.



# Selmanaj: Po u vjen fundi dembelëve brenda sistemit të drejtësisë

Zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, së bashku me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, kanë prezantuar të mërkurën gjetjet e raportit të titulluar "Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e vettingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë". Ai ka thënë se qeveria pritët që të vendosë për njërin nga modalitetet që i janë ofruar në raportin e grupit punues. Selmanaj ka paralajmëruar se me modalitetin që do ta zgjedhin do t'u vijë fundi dembelëve brenda sistemit të drejtësisë, të korruptuarve dhe atyre që deri më sot kanë pasur një qasje të papërgjegjshme



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 DHJETOR 2020 - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, si dhe kryesuesin e grupit punues, Florent Spahija, kanë prezantuar raportin e grupit punues për adresimin e sistemit të llogaridhënies, duke përfshirë edhe vettingun në sistemin e drejtësisë. Ministri Selimi ka thënë se hartimi i këtij raporti është hapi i parë për krijimin e një sistemi të llogaridhënies në fushën e drejtësisë. "Faleminderit që sot jeni këtu për lansimin e raportit për sistemin e llogaridhënies, duke përfshirë edhe vettingun. Falënderoj zëvendëskryeministrin Selmanaj dhe kryesuesin e

grupit 'Spahija, por edhe anëtarët e grupit punues si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për punën e bërë për hartimin e këtij raporti. Ky është vetëm hapi i parë për të krijuar një sistem më llogaridhënës dhe më të fortë për t'i mbrojtur prokurorët dhe gjyqtarët e ndershëm dhe për t'i larguar ata që nuk janë të ndershëm", ka deklaruar ministri Selimi. Sipas Selimit, sistemi i llogaridhënies, përfshirë edhe vettingun, duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe nuk duhet të bëhet politik. "Nëse duhet ta kemi një sistem të drejtësisë së pavarur dhe llogaridhënës duhet të bëhet duke i përfshirë ata. Nuk duhet të bëhet politik sepse preferencat politike ndryshojnë përdorin sistemi i drejtësisë duhet të jetë

permanent", ka thënë ai. Ministri Selimi ka theksuar se beson që në muajin janar të fillohet implementimi i njërit prej modaliteteve të dala nga raporti i grupit punues për sistemin e llogaridhënies. Edhe zëvendëskryeministri Driton Selmanaj ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës pritët të vendosë për njërin nga modalitetet që i janë ofruar në raportin e grupit punues. "Neve na janë ofruar katër modalitete. Neve si qeveri na mbetet të vendosim për

njërin nga modalitetet që na është ofruar nga grupi punues, ta zgjedhim njërin nga modelet që është më i përshtatshëm për Kosovën. Jemi të bindur që me modalitetin që do ta zgjedhim jemi të sigurt që po u vjen fundi dembelëve brenda sistemit të drejtësisë, të korruptuarve dhe atyre që deri më sot kanë pasur një qasje të papërgjegjshme", ka thënë zëvendëskryeministri Selmanaj. Ndërsa kryesuesi i grupit punues nga KDI-ja, Florent Spahija, ka thënë se raporti i

dorëzuar përmban katër modalitete që lidhen me llogaridhënien, duke përfshirë edhe vettingun. "Ekspertiza jonë dhe e grupit punues ka bërë që të vijmë me katër modalitete. Modaliteti i parë është status quoja, ajo ku jemi deri tash e që po shohim se nuk ka as vullnet për të vazhduar. Janë edhe tri modalitete të tjera, si: ndryshimet ligjore, modaliteti i vettingut të përhershëm dhe modaliteti gjithëpërfshirës që fillon menjëherë dhe kryhet pas pesë vjetësh", ka thënë Spahija.

# Quni: Objektivi i Kosovës, të bëhet pjesë e iniciativave rajonale

EPOKA  
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ishte pjesëmarrës i takimit "Bashkëpunimi mbrojtës i Evropës Qendrore", që u mbajt të mërkurën në Slloveni përmes video-komunikimit. Pjesëmarrja e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në këtë takim ishte një mundësi e mirë për t'i shprehur qëndrimet dhe objektivat e Kosovës në fushën e bashkëpunimit dhe sigurisë me vendet evropiane si dhe gatishmërinë për ta dhënë kontributin në fushën e sigurisë, në nivelin regional, evropian dhe global. Duke folur për aspiratat e qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës, për të qenë pjesë e integruar e botës euroatlantike, ministri Quni ka thënë se qëllimi dhe objektivi strategjik i Kosovës është që sa më parë të bëhet pjesë e iniciativave të ndryshme rajonale si anëtare me të drejta të



plota. "Ky është një parakusht dhe është në përputhje me aspiratat tona për t'u integruar në proceset euroatlantike dhe unë mund t'ju siguroj që të gjithë krahët politikë në Kosovë janë të orientuar absolutisht drejt integritimit euroatlantik. Ne po punojmë në këtë drejtim. Ne jemi të vetëdijshëm për këtë sfidë dhe do t'i bëjmë të gjitha përpjekjet tona për ta arritur atë", ka deklaruar Quni. Po ashtu, ministri Quni ka

shprehur gatishmërinë që Kosova ta japë kontributin e vet edhe përmes angazhimeve konkrete për ruajtjen e paqes, krah për krah shteteve të aleancës veriatlantike, në të mirë të paqes së përgjithshme. "Është një fakt i njohur, që për momentin Kosova është një konsumatore e sigurisë, e siguruar nga angazhimi operativ CSDP (Siguria e Përbashkët dhe Politika e Mbrojtjes) përmes EULEX-it dhe operacionet e

NATO-s/KFOR-it. Unë mund ta konfirmoj gatishmërinë e qeverisë sonë për të bashkëpunuar me të, por ne nuk duam të mbetemi vetëm konsumatorë", është shprehur ministri Quni. Në fjalën e tij, ministri Quni një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe gatishmërisë së Kosovës për të bashkëpunuar edhe më ngushtë me shtetet evropiane, me institucionet evropiane të sigurisë për ta dhënë kontributin

edhe Kosova si shtet. "Unë do të doja ta përdor këtë forum për ta shprehur dëshirën tonë për të kontribuar në misionet ndërkombëtare dhe operacionet e drejtuara nga BE-ja. Dhe ne si qeveri do t'i ndërmarrim hapat e nevojshëm përpara për të arritur këtë qëllim", ka thënë ai. Në përfundim të fjalës së tij, ministri Quni ka theksuar rëndësinë e ndihmës dhe të përkrahjes nga vendet evropiane për t'i realizuar këto qëndrime dhe objektiva, që do të ishin jo vetëm në të mirë të sigurisë së Kosovës, por edhe vetë Evropës dhe sigurisë së përgjithshme. "Si përfundim, unë do të doja të ritheksoj se Kosova e konsideron këtë forum si një platformë e vlefshme për rritjen e partneriteteve dhe nxitjen e procesit të integritimit euroatlantik dhe unë do të doja ta shfrytëzoja këtë mundësi për ta kërkuar mbështetjen tuaj për Republikën e Kosovës", ka deklaruar ministri i Mbrojtjes, Anton Quni.

# Hoti dhe përfaqësuesit e odave ekonomike do të punojnë së bashku për pakon e re ekonomike

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të mërkurën një takim me përfaqësuesit e Odave Ekonomike. Në një konferencë për media ai ka bërë me dije se janë marrë vesh për të punuar bashkë

rreth një pakoje të re ekonomike. "I informova në detaje për përgatitjet që kanë bërë institucionet e ndryshme për ta zbatuar secilin prej neneve të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. U morëm vesh që të punojmë bashkë për dizajnimin e masave për pakon e re të rimëkëmbjes ekonomike për

vitin 2021, që është pjesë e buxhetit për vitin 2021. Po ashtu, u morëm vesh edhe për hartimin e një pakoje fiskale që të miratohet në fillim të muajit janar", ka thënë Hoti. Brenga më e madhe e përfaqësuesve të odave ekonomike, sipas Hotit, ishte çështja e kohës apo e orarit se kur mbyllet ekonomia. "I

kuptoj brengat e tyre dhe pasojat që i kanë pasur në bizneset e tyre nga masat që i kemi vendosur e që i kemi diskutuar bashkërisht. Brenga kryesore e shumicës është që të rishqyrtohet koha, orari i mbylljes së bizneseve dhe i komplet ekonomisë, dhe disa elemente specifike që kanë të bëjnë me funksionimin e disa

sektorëve", është shprehur kryeministri Hoti. Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se në këtë takim kishte konsensus që të ketë konsulta për çdo vendim që do të merret për masat anti-Covid, duke paralajmëruar se çdo mbyllje eventuale totale do të ishte një bllokadë për bizneset.



## Katër ndërkombëtarë në listën për dëshmitarë në procesin e privatizimit

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ


PRISHTINË, 16 DHJETOR - Në Komisionin Hetimor Parlamentar, lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, pritet të dëshmojnë edhe katër ndërkombëtarë të cilët kanë punuar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në Kosovë. Në listën që ka siguruar gazeta "Epoka e re", emri i tyre figuron për privatizimin në kohën e

AKM-së, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e që më pas emri u shndërrua në AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Në listën e dëshmitarëve, pas paraqitjes së Mimoza Kusari-Lilës në listë, janë këta katër dëshmitarë ndërkombëtarë: Andy Bearpark (AKM), Jasper Dick (AKM), Herbert Schmidt (AKM), dhe Jorgen Mendike (AKM).

Lista pastaj vazhdon me personat nga Kosova. Po kjo listë

mund të ndryshohet në varësi të propozimit të deputetëve të cilët janë pjesë e këtij komisioni. Me iniciativë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), deputetët e Kuvendit të Kosovës më 10 qershor votuan themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do të hetojë dhe t'i zbardhë të gjitha privatizimet e bëra në Kosovë, në veçanti keqpërdorimet e mundshme dhe ato me lidhje politike.





## Kosova dhe Serbia përplasen në takimin virtual të CEFTA-s

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, e ka kundërshtuar sekretaren shtetërore të Serbisë, Olivera Joçiq, e cila në takimin virtual të anëtarëve nënshkrues të CEFTA-s ka thënë se Kosova nuk duhet të trajtohet si shtet. Krasniqi ia ka bërë me dije Joçiqit se Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, e njohur nga shtetet më të fuqishme dhe më të zhvilluara të botës



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka replikuar me sekretaren shtetërore të Serbisë, Olivera Joçiq, e cila, në një takim virtual të anëtarëve nënshkrues të CEFTA-s, ka kundërshtuar që Kosova të trajtohet si shtet. Ministri Krasniqi i është kundërvënë duke ia bërë me dije se Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, e njohur nga shtetet më të fuqishme dhe më të zhvilluara të botës. "Pak ka rëndësi a na njih Serbia. Ne po përpiqemi të kemi raporte të një fqinjësie të mirë. Por duhet ta

dini se Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, si e tillë është e njohur nga shtetet më të fuqishme të botës. Prandaj edhe kërkesat e mia si ministër, që Kosova të trajtohet si e tillë, janë legjitime dhe të qëndrueshme", ka deklaruar ministri Krasniqi. Krasniqi edhe në këtë takim ka përsëritur kërkesën që emërtimi UNMIK-Kosovo të hiqet dhe të shkruhet vetëm Republika e Kosovës. "Kërkesën për heqje të emërimit UNMIK-Kosova e kam bërë edhe në takimet që kam zhvilluar në Bruksel, në Sekretarinë e CEFTA-s dhe po e përsëris edhe në këtë takim, se Kosova është shtet i pavarur dhe duhet të trajtohet nga të gjithë

anëtarët e CEFTA-s", u shpreh ministri Krasniqi. Kreu i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu ka kërkuar nga të gjithë anëtarët ta respektojnë marrëveshjen e CEFTA-s, me theks të veçantë

Serbia, e cila po u nxjerr telashe bizneseve dhe mallrave të Kosovës kur kalojnë transit nëpër Serbi. "Deri tashti shenja e konformitetit, sipas marrëveshjes së CEFTA-s (CE), nuk po zbatohet nga shteti i

Serbisë, andaj ju paralajmëroj se në zbatim të marrëveshjes do të marrim masa që në shtetin e Kosovës të hyjnë vetëm ato mallra që kanë shenjën e konformitetit CE", ka deklaruar në fund ministri Krasniqi.

## Bordi i Postës harmonizon pagat sipas gradave nga 8 deri në 17



**EPOKA ERE** A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Postës së Kosovës në mbledhjen e të mërkurës ka aprovuar planin e biznesit për vitin 2021-2023. Posta e Kosovës me anë të një komunikate për media ka bërë me dije se për shkak të gjendjes së rëndë financiare dhe pamundësisë së arkëtimit në biznesplanin e aprovuar të mërkurës nga Bordi, janë harmonizuar pagat e gradave nga 17 deri në 8, ndërsa shpenzimet e stafit janë reduktuar nga 6 për qind deri në 30 për qind. "Nga ky planifikim i reduktimit të shpenzimeve të stafit, Posta e Kosovës ka kursyer rreth 300

mijë euro vjetore. Bordi ka vlerësuar se kjo është një masë e domosdoshme, por e përkohshme deri në tejkalimin e situatës së pandemisë, ndërsa harmonizimi i gradave do të rishikohet kohë pas kohe dhe, varësisht nga përmirësimi i gjendjes, do të vlerësohen gradat e menaxhmentit të lartë dhe të mesëm, duke pasur parasysh ngritjen e të hyrave dhe forcën e likuiditetit", është thënë në komunikatën e Postës së Kosovës të lëshuar nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Postës, Leonard Shabanaj. Sipas kësaj komunikate, bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ka kërkuar motivim shtesë nga menaxhmenti për t'i ngritur të hyrat dhe përmirësuar rezultatit financiar të Postës së Kosovës.

## Bitcoin prek shifrën 20 000 dollarë për herë të parë ndonjëherë

Nju Jork, 16 dhjetor - U desh pak kohë, por më në fund ndodhi: Një bitcoin aktualisht vlen më shumë se 20 000 dollarë. Numri ka një domethënie të veçantë për ithtarët e kriptovalutës. Më 17 dhjetor 2017, pas një periudhe të rritjes intensive, Bitcoin hyri në spektrin e 20 000 dollarëve, por u rrëzua fort në dy ditët e

ardhshme, duke shkaktuar një rënie deri në 3 200 dollarë. Bitcoin u afrua përsëri disa herë këtë nëntor dhe dhjetor, por çmimi ndaloi afër 20 000 dollarë, i ndjekur nga disa rënie shumë intensive. Tani, megjithatë, ngritja e tij nuk është ndalur. I nxitur nga një varg lajmesh të

mira, rritja e çmimit ishte e pandalshme. Kriptovalutat e tjera janë duke bërë mirë gjithashtu, me Ethereum që kushton 600 dollarë dhe XRP që kushton 0,46 dollarë - jo nivelet e tyre më të larta ndonjëherë, por goxha larg ngërçit që ishin në pranverën e kaluar.



## Testet serologjike do të bëhen edhe në Qendrën e Shëndetit Publik në Gjilan

GJILAN, 16 DHJETOR (ER) - Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, nën udhëheqjen e drejtorit të Shëndetësisë, Selami Xhemaili, ka mbajtur mbledhjen e radhës për vlerësimin e situatës me virusin në dy ditët e fundit. Në takim u konfirmua se ditët e fundit Gjilani ka shënuar rënie të numrit të rasteve pozitive, ku aktualisht janë

231 raste aktive. Drejtoresha e Qendrës Rajonale e Shëndetit Publik në Gjilan, dr. Ajhane Sefiu, ka deklaruar se pas trajnimit të stafit aty, nga e mërkura do të fillojnë testet aerologjike në këtë komunë. "Fillimisht do të testohet stafi shëndetësor i shëndetësisë primare dhe sekondare, për të vazhduar me policinë dhe të gjithë qytetarët. Ndërkohë, shumë shpejt do të fillojmë punimin

e testeve për RT-PCR. Jemi të lumtur që kemi arritur në këtë nivel falë aparaturës që na ka ardhur në Gjilan", ka deklaruar Sefiu. Gjendja e përgjithshme e përbaljes me pandeminë në Gjilan është kjo: nga 7 397 teste, 2 927 kanë rezultuar pozitivë, 2 609 janë shëruar, 86 të vdekur, 232 raste aktive, 55 janë të shtrirë në spital dhe për 80 mostra po priten rezultatet.



## Foshnja e parë e porsalindur në Kamenicë gëzon subvencionimin prej 200-eurosh



KAMENICË, 16 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka uruar foshnjën e parë që gëzoi subvencionin në vlerë prej 200-eurosh. Kastrati ka thënë se 37 çifte kanë aplikuar për subvencionim. "Aneli është

gëzimi i parë i Arditit dhe Evgjenisë, si dhe foshnja e parë në Kamenicë që gëzoi subvencionin në vlerë prej 200 eurosh. Ndonëse ky vit nuk ishte fort i këndshëm për të gjithë, dhuratën më të madhe patën 37 çiftet që morën epitetin prindër e që kanë

aplikuar për subvencionim. Anel, je dhurata më e mirë për prindërit e tu. Jetofsh gjatë!", ka thënë ai. Kryetari Kastrati ka marrë vendim që tash e tutje t'i subvencionojë çiftet e reja me nga 200 euro si mbështetje për foshnjat e porsalindura.

## Shpërndahet material didaktik për nxënësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas

LIPJAN, 16 DHJETOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Lulzim Qerimi, me bashkëpunëtorë, ka vizituar të mërkurën shkollat në Gadime dhe Medvec, ku nëpërmjet DKA-së në Lipjan dhe fondacionit të këshillit të Evropës, programit "Romacted", është shpërndarë

material didaktik për të gjithë nxënësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. Nënkryetari Qerimi ka falënderuar grupin komunitar nga Komuna e Lipjanit për angazhimin dhe bashkëpunimin e përbashkët për mirëqenien e komuniteteve në këtë komunë.



## Inspektohet zbatimi i masave kundër Covidit në Malishevë

MALISHEVË, 16 DHJETOR (ER) - Në kuadër të zbatimit të masave kundër Covidit dhe zbatimit të vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për kategorizimin e komunave sipas nivelit të rrezikshmërisë së përhapjes së virusit "Korona", inspektorati komunal në Malishevë, së bashku me shtabin komunal emergjent dhe Policinë e Kosovës, në vazhdimësi po mbikëqyrin zbatimin e masave dhe vendimeve, sidomos nga subjektet afariste për zbatimin e orarit të punës. Aksion i tillë ka qenë edhe gjatë dy netëve të fundit ku, pas orës 18:00, inspektorati komunal në Malishevë, së bashku edhe me shtabin komunal emergjent, i ka vizituar subjektet afariste në

shumicën e territorit të Komunës së Malishevës, për ta inspektuar zbatimin e masave dhe vendimeve. Sipas drejtorit në Drejtorinë e Inspektoratit, Dibran Kastrati, shumica dërrmuese e subjekteve afariste janë duke i zbatuar vendimet dhe të gjitha subjektet afariste mbyllën sipas orarit të përcaktuar. "Ka ndonjë përjashtim kur mund të ketë vonesa të arsyeshme për ndalimin e punës në orën 18:00, por ka mirëkuptim dhe pronarët janë të vetëdijësuar për zbatimin e këtij orari", ka thënë Kastrati. Inspektorati në Komunën e Malishevës u ka bërë me dije të gjitha subjekteve, se orari duhet të respektohet dhe se këto masa janë obliguese për të gjithë pa përjashtim.



# Narracion përmbysës



Shkruan: Agron HOTI

Edhe nëse nuk kishte pasur 'konkurs publik' për këtë 'garë' të pandershme, të gjitha veprimet shkonin në atë drejtim, pra po 'garohej' se kush po e paraqiste më keq Kosovën e mitur, e cila në vitin 2015 s'kishte më shumë se shtatë vjet shtet. Pra, po ndërtohej një narracion aq përmbysës sa thua ti, gabim paska qenë formimi i shtetit të Kosovës. Deri këtu shkohej.

Dhe në vend që një shtet i mitur siç ishte Kosova e gjenociduar nga Serbia të mbështetej më shumë se çdo shtet tjetër në Evropë për ta marrë veten, pavarësisht të metave që mund t'i kishte çdo shtet tjetër në moshë të tillë, po ndodhte pikërisht e kundërta. Sa më shumë që mbillje vrer, aq më i dashur bëheshe; sa më mirë që flisje për të arriturat e shtetit tënd sado modeste nganjëherë, aq më i keq dukesh, mesin e artë edhe ashtu e kishim eliminuar si mentalitet gjithëshoqëror. Pra, po i kërkohej performim perfekt një shteti të mitur (pra idealja e ideale) duke harruar krahurat e kaluara dhe problemet e pafundme që po e prisnin pikërisht shtetin e mitur.

E në vend se Kosova nga viti 2015, së paku t'i kishte të hequra vizat, ta kishte të implementuar mbi gjysmën e MSA-së, t'i kishte të hapura negociatat për anëtarësim në BE, thjesht të gëzonte shumë më tepër perspektivë evropiane sesa Serbia që bëri kasaphanën ndaj shqiptarëve në zemër të Evropës, ajo sot ka një barrë aq të rëndë ndërkombëtare mbi kuriz siç është Gjykata Speciale, saqë kjo edhe në variantin më të mirë do të na mbajë të bllokuar në rrafshin

ndërkombëtar, së paku deri në fund të vitit 2023 me bllokim të mëtejshëm njohjesh të pesëshes së BE-së dhe të tjerave nëpër botë, bllokim anëtarësimi në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë, bllokim dialogu e marrëveshjeje finale me Serbi dhe bllokim të integritit evropian në tërësinë e tij. Po ndodhi e kundërta, do të ishte mrekullia vetë.

Historia do ta vërtetojë më së miri se a kishte filluar që në 2015-n, ndoshta edhe më përpara, të përgatitej terreni për të krijuar një klimë aq fajësuese ndaj çlirimtarëve të Kosovës për punë që kur do të ndodhnin arrestimet e çlirimtarëve nga Specialja të mos krijohej ndonjë destabilizim i mundshëm i gjendjes së përgjithshme. Nuk kishte raport apo deklaratë brenda dhe jashtë që s'po ndërtonte narracion përmbysës. Një gjë dihet, për ta vrarë lavdinë e çlirimtarëve kërkohej denigrim e goditje e orkestruar e asi përmasave sa as qeni të mos ta njihte të zotin. E për ta vrarë lavdinë nuk është se nuk kontribuuan edhe vetë çlirimtarët (jo të gjithë) përmes lakmisë së shfrenuar, asgjëbërjes së shumë zhvillimeve, dekurajimit të vazhdueshëm të profesionalizmit dhe inkurajimit të injorancës në shkallë të gjerë pothuaj në çdo cep të qeverisjes. Pra, nëse kishte një orkestrim të tërë brenda dhe jashtë vendit për ta goditur projektin e çlirimtarëve, pra Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, çoroditjet e kohëpaskohshme të çlirimtarëve (jo të gjithë) vetëm sa po i vetëkontribuonin këtij orkestrimi, fundja thonë "ç'ta bën vetja, s'ta bën askush".

Në funksion të këtij demoralizimi shoqëror-politik nuk u pengua fare as eksodi i mbi 100 mijë shqiptarëve që lëshuan Kosovën në fund të vitit 2014 dhe në fillim të 2015-s. Se a fshihej diç më e madhe brenda dhe prapa këtij eksodi do ta mësojmë më vonë ose kurrë. Një gjë dihet: nëse

eksodi do të ishte në të mirë të Kosovës dhe kundër Serbisë, kjo e fundit menjëherë do t'i mbyllte kufirin këtij eksodi dhe nuk do të inkurajonte e transportonte kurrë shqiptarë të Kosovës me mjete civile e ushtarake nga Beogradi dhe zona të tjera drejt kufirit hungarez. Pastaj, edhe sot është e pakuptueshme hapja e kufirit nga Hungaria për eksodin e Kosovës që po vinte përmes Serbisë pa u kritikuar asnjëherë nga Brukseli zyrtar për këtë shkelje të rëndë të kufirit të jashtëm të Zonës Schengen nga Hungaria, diçka që për refugjatët sirianë BE-ja kishte kritikuar shtetet kryesisht jugore që përbëjnë kufirin e jashtëm të BE-së, pa e përjashtuar këtu as Hungarinë.

Derisa eksodi po ushqente demoralizimin shoqëror-politik, në atë situatë të rëndë - ashtu sikurse në shumicën e vendeve të BE-së po fitonte terren fryma populiste në Kosovë, e cila me sulmet e saj ndaj institucioneve publike dhe figurave politike dhe në funksion të ndërtimit të narracionit përmbysës po synonte denigrimin dhe degradimin e çdo të arriture në Kosovë siç, para së gjithash, ishin mosnjohja e vetë shtetit me simbole dhe kundërshtimi i çdo të arriture, pavarësisht prej vështirësive të pafundme historike për arritjen e tyre. Emërues i përbashkët i popullistëve të BE-së dhe atyre në Kosovë ishte rritja e ndjenjës anti-establishment duke luajtur me tema të mëdha si korrupsioni, krimi i (pa)organizuar dhe migracioni, diçka që vazhdon edhe sot, edhe pse me intensitet më të vogël.

Përderisa popullistët në BE po fitonin terren shkaku i efekteve të krizës financiare globale dhe krizës së refugjatëve sirianë që po shkundnin kohezionin e BE-së, popullistët në Kosovë po fitonin terren nga siç e quanin "zbrazja e Kosovës si rezultat i korrupsionit." Përderisa popullistët e BE-së po akuzonin elitat politike atje të

kishin dështuar në parandalimin e luftimit e korrupsionit si dhe parandalimin e migracionit, popullistët në Kosovë po akuzonin elitat politike se zbrazja e Kosovës po ndodhte pikërisht për shkak të korrupsionit. Përderisa popullistët në BE po vajtonin kinse vdekjen e BE-së që sipas tyre po tjetërsohej nga migracioni i (pa)rregullt, popullistët në Kosovë s'po njihnin institucionet e një shteti që kishte lindur nga gërmadhat. Ashtu sikurse popullistët në BE edhe ata në Kosovë po ndanin me llupë të këqijat nga të mirat dhe përmes të këqijave po mbillnin kob e zi. Nuk qe e rastësishme rritja e frymës populiste pikërisht gjatë asaj kohe në Kosovë e BE, ashtu sikurse që nuk është e rastësishme rënia e tyre graduale sot.

Në 5 apo 6 vitet e fundit aq shumë ka pasur vërshim të pafre narracionesh negative përmbysëse ndaj Kosovës si vend i krimin të (pa)organizuar dhe korrupsionit, sa kur zgjohesh në mëngjes ende pa u kthjellur mirë, shihje qarqe pa fund nga brenda dhe jashtë, ballina mediale, opinionistë të ndryshëm, që mbillnin pafund kob e zi ndaj një vendi më pak se 12 vjeçar. Aq shumë demonizohej e akuzohej Kosova, sa thua ti ne e paskëshim zbuluar krimin e (pa)organizuar dhe korrupsionin dhe për këtë zbulim po u dashka që me çdo kusht të futemi në libër të Ginisit e bota nuk po na lejuaka se qysh para nesh paska pasur raste korruptive, kështu dukej së paku perceptsoni. Aq të mëdha i kishin kritikuar dhe kërkesat ndaj një Kosove të mitur qarqe brenda dhe jashtë saj, saqë po të ishte edhe ndonjë alamet shtet i Evropës në vend të Kosovës do ta kishte të pamundur t'i përmbushte të gjitha pritjet dhe adresonte të gjitha kritikuar. Qe krijuar përshtypja që korrupsion kishte emrin Kosovë dhe se askush më nuk e

kishte kurajën të fliste për miliarda e trilionat euro që çmendnin me korrupsion e krim të (pa)organizuar (përfshirë shpëlarjet e parave) gjetkë nëpër Evropë e botë. Qe krijuar po ashtu përshtypja që Kosova ishte bërë e keqja e tërë botës dhe se për ta luftuar atë do të duhej çuar në këmbë e tërë bota. E sikur akuzat e përditshme, secila më e rëndë se tjetra - ndaj një shteti të mitur të mos mjaftonin, Serbia vetëm sa po i kontribuonte rëndimit të situatës me sulmet e saj të pareshtura me aleatë të saj në Këshill të Sigurimit dhe në mekanizma të tjerë rajonalë e ndërkombëtarë duke u mundur ta paraqiste Kosovën si të keqen dhe Serbinë të mirën e rajonit. Po të flisje për progres në këto 5 apo 6 vitet e fundit të qanin të çmendur ose të shitur, pavarësisht realitetit në terren. I mirë do të konsiderohesh vetëm nëse shaje dhe demonizojë shtetin tënd të mitur, të gjithë të tjerët që flisnin ndryshe quheshin të këqij.

Me anë të këtij shkrimi nuk dua në asnjë mënyrë të arsyetoj as edhe një dukuri të vetme negative në vendin tim, më të riun në Evropë, se lëre më krimin e (pa)organizuar dhe korrupsionin. Por, nëse as edhe një vend i vetëm në Evropë, me një traditë shtetërore së paku 100-vjeçare nuk kishte qenë në gjendje ta zhdukte krimin e (pa)organizuar dhe korrupsionin, por përkundrazi edhe sot po përballej siç do të përballet edhe nesër me të, atëherë si paska mundësi që një shtet 12 vjeçar ta zhdukte atë, bile ende pa e përfunduar shtetndërtimin e shoqëruar me probleme të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëse as edhe një shtet i botës, sado i zhvilluar dhe demokratik të ketë qenë (me shtetësi qindra vite më të gjatë se Kosova), nuk kishte mundur ta zhdukte krimin e (pa)organizuar dhe korrupsionin për t'u bërë model i botës, atëherë si paska mundësi që një shtet 12-vjeçar ta zhdukte atë e të bëhej model bote?! (Vijon)

## Telekomi do të vendosë antena të reja në disa lokacione në Podujevë

PODUJEVË, 16 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të mërkurën në takim Bislim Fetahun, drejtor teknik i Telekomit të Kosovës. Në këtë takim Bulliqi dhe Fetahu biseduan për

bashkëpunimit dhe përmirësimin e shërbimeve të kësaj kompanie për qytetarët e Komunës së Podujevës. Gjatë takimit u bisedua për investimet që planifikohen të realizohen nga Telekomi i Kosovës për zgjerim të rrjetit.

Në këtë drejtim drejtori teknik i Telekomit, Bislim Fetahu, ka thënë se në disa lokacione brenda territorit të Komunës së Podujevës do të vendosen antena të reja me kapacitet më të lartë të shpërndarjes së valëve të telefonisë dhe të internetit.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Ponte Prizreni triumfon në Suharekë, Vëllaznimi mposhtet nga Rahoveci

**SUHAREKË, 16 DHJETOR** - KB Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit si mysafir 62:71 (9:24, 26:13, 19:18, 8:16) në kuadër të javës së tetë të Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshjen më mirë e nisën mysafirët, duke fituar çerekun e parë me rezultat 9:24. Por, therandasit nuk kishin hyrë për t'u dorëzuar dhe u rikthyen në periodën e dytë, duke e fituar 26:13, për të shkuar në pushimin mes dy pjesëve 35:37. Lojë më e barabartë u zhvillua në periodën e tretë, 19:18, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 44:45, duke e bërë ndeshjen shumë interesante. Megjithatë, në 10 minutat e fundit prizrenasit ishin më të mirë, 8:16, për të triumfuar në fund 62:71. Griffin Rame ishte më i dalluari te Golden Eagle Ylli me 20 pikë, nëntë kërcime dhe tetë asistime, kurse Arti Hajdari me 22 pikë, shtatë kërcime e gjashtë asistime dhe Joshua Martin me 13 pikë e 15 kërcime ishin më të dalluarit te Ponte Prizreni. Golden Eagle Ylli ka katër fitore dhe katër humbje, kurse Ponte Prizreni pesë fitore dhe tri humbje. Ndërsa KB Rahoveci ka shënuar fitoren e katërt me radhë, duke mundur Vëllazninin në udhëtim 57:68 (23:17, 11:13, 10:24, 13:14), në kuadër të javës së tetë të Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Te Vëllaznimi më të dalluarit ishin Cendrik Council me 20 pikë dhe 17 pikë dhe Christopher Hortman me 14 pikë e 12 kërcime, derisa te Rahoveci më të dalluarit ishin Amadi Ikpeze me 13 pikë e 18 kërcime, Marvin Jones me 21 pikë dhe Isaiah Traylor me 19 pikë. Vëllaznimi ka tri fitore dhe pesë humbje, kurse Rahoveci gjashtë fitore dhe dy humbje.



Sot zhvillohen derbi Prishtina - Peja

Sot (e enjte) do të përballen skuadrat me rivalitet të madh, Sigal Prishtina do ta presë Pejën në një sfidë shumë interesante. "Bardhekaltrit" kanë dy fitore dhe pesë humbje, kurse pejanët janë në vendin e parë me gjashtë fitore dhe një humbje. Këto dy skuadra do të ballafaqohen edhe në çerekfinale të Kupës së Kosovës. Trepça dhe Bashkimi janë dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. Sfidat në

'Minatori' pritet të jetë shumë interesante, sepse të dyja skuadrat kanë nga dy fitore dhe pesë humbje në këtë edicion.

**PRINCE CAFFË SUPERLIGA - JAVA 8**

Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni 62:71  
Vëllaznimi - Rahoveci 57:68

Të enjten takohen:  
15:00 Sigal Prishtina - Peja  
15:00 Trepça - Bashkimi

SHKURT

**Kuvendi Zgjedhor i FBK-së, pa praninë e mediave**

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) të premten, më 18 dhjetor, do ta mbajë Kuvendin e Rregullt Zgjedhor. Kuvendi do të mbahet në orën 15:00 në Hotel "Four Points by Sheraton Prishtina". Për shkak të masave anti-Covid në këtë Kuvend janë të lejuar vetëm 50 persona të jenë në sallë, kurse janë 39 delegatë. "Për këtë arsye edhe numri i pjesëmarrësve është i limituar dhe Kuvendi do të jetë i mbyllur për media. Megjithatë, FBK-ja do t'u dërgojë të gjitha mediave pamje (video), fotografi dhe deklarata nga ky Kuvend", thuhet në njoftimin e FBK-së. Siç është bërë me dije më herët, kryetari aktual i FBK-së, Arben Fetahu, do të jetë kandidati i vetëm në Kuvendin Zgjedhor, pasi ka siguruar nominimet e nevojshme nga klubet.

**Interi ofron Eriksonin për Xhakën**

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Xhaka, mund të largohet në janar nga klubi anglez. Xhaka është kritikuar shumë pas kartonit të kuq që mori në ndeshjen e fundit ndaj Burnleyt dhe e ardhmja në Arsenal nuk duket të jetë e sigurt. Në anën tjetër, Interi ka shfaqur interesim për futbollistin që përfaqëson Kombëtaren e Zvicrës, për të cilin është gati ta ofrojë mesfushorin Christian Erikson. Danezi nuk bën pjesë në planet e trajnerit Antonio Conte dhe dëshiron të ndryshojë klub që në afatin e janarit. 28-vjeçari Xhaka në vitin 2016 iu bashkua Arsenalit nga Borussia Monchengladbach dhe nga ajo kohë ka regjistruar 140 paraqitje.

**Zendeli do të garojë në Formula 2: Ditë shumë e veçantë për mua**

Shqiptari Lirim Zendeli do të paraqitet për herë të parë në një garë në Formula 2. Zendeli do të jetë shoferi i Mpmotorsport, me të cilët ka arritur marrëveshje. Ai ka thënë se kjo është ditë e veçantë për të sepse më në fund do të vozisë në Formula 2. "Sot është një ditë shumë e veçantë për mua. Më në fund mund t'ju them se do të vozis për officialmpmotorsport për vitin e parë në Formula 2. Falënderues dhe më shumë se 100 për qind i gatshëm të vazhdoj të dhe të paraqitem mirë në vitin 2020", ka shkruar ai në "Instagram".

# Prishtina, Ballkani dhe Llapi kalojnë në rrethin tjetër të Kupës

**PRISHTINË, 16 DHJETOR** - Kanë përfunduar gjashtë takime në kuadër të Kupës së Kosovës në fazën 1/16 e finales. Vëmendja ishte në dy takime: Kosova e Prishtinës - Prishtina dhe Ballkani - Dardana. Fituesja në fuqi e Kupës, Prishtina, nuk kishte aspak mëshirë për rivalin lokal, pasi i shënoi gjashtë gola, kurse vendasit shënuan vetëm dy gola. Ballkani në anën tjetër mori fitore minimale në udhëtim te Dardana, duke fituar me epërsi minimale 1-0. Rezultatet: Flamurtari-Drenasi (1-0), A&N-Kika (5-1), Besa-Istogu (0-2), Onix-Llapi (2-4), Kosova VR-Prishtina (2-6), Dardana-Ballkani (0-1).



## 'Fenomeni': Unë, Messi dhe CR7 do t'i kishim tmerruar kundërshtarët

PARIS, 16 DHJETOR - Formacioni më i mirë i historisë, i hartuar nga "France Football", shkaktoi diskutime për një formacion sa spektakolar aq edhe të paekuilibruar, por sigurisht entuziazmoi një nga protagonistët e asaj

njëmbëdhjetëshe. Ronaldo "Fenomeni", i cili u përfshi si sulmues qendror me Cristiano Ronaldon dhe Lionel Messin në krah, i kontaktuar nga revista e famshme franceze, ka thënë se nëse do të luanin bashkë me Messin dhe CR7,

mbrojtësit do të tmerroheshin. "Çfarë ekipi i çmendur. A mund ta imagjinoni nëse do të mund t'i kishim luajtur të tre, së bashku!? Mbrojtësit do të ishin tmerruar... Publiku do të kishte qenë i çmendur nga

dashuria. Kam pasur mundësinë të përballesha me secilin prej tyre në fushë dhe duhet të them se ata bënë historinë e futbollit. Prania e tyre në 'Drem Team' është më se e merituar", ka thënë Ronaldo.



## Më 23 dhjetor shpallen laureatët e vitit 2020, stinori pranveror nis më 13 shkurt



PRISHTINË, 16 DHJETOR - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi, ku ka diskutuar për çështje me rëndësi në futbollin e Kosovës. KE analizoi përfundimin e garave të stinorit vjeshtor në të gjitha ligat. Nga diskutimet e anëtarëve të KE-së u konstatua se garat patën rrjedhë të mirë, me dinamikën e paraparë në kushtet dhe rrethanat aktuale të pandemisë Covid-19, ku ndeshjet u zhvilluan me orar të ngjeshur. Komiteti Ekzekutiv falënderon klubet për angazhimin maksimal në mbarëvajtjen e garave. Gjatë rrjedhës së garave pati edhe ankesa të klubeve, sidomos drejt

referimit, por u vlerësua se ato ishin gabime njerëzore dhe nuk ishin të qëllimshme. "KE mendon se të gjitha segmentet e garave dhe puna e secilit do të trajtohen me kujdes dhe në përputhje me aktet normative dhe karshi kësaj do të merren edhe masat e duhura drejt përmirësimit të cilësisë së garave. KE gjatë pandemisë, por edhe në fillim të garave i ka mbështetur klubet financiarisht, derisa KE falënderon edhe MKRS-në që ka mbështetur klubet e futbollit sipas pakos për rimëkëmbje. KE është i vendosur që edhe më tutje të qëndrojë pranë klubeve", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në këtë mbledhje KE mori vendim që stinori pranveror të

fillojë më 13 shkurt 2021 dhe të përfundojë më 30 maj 2021. Duke shqyrtuar kërkesat e klubeve të Ligës së Parë që të vazhdohet me formatin e njëjtë të garave edhe për një kampionat, KE mori vendim që të miratojë këtë kërkesë të klubeve gjithnjë në të mirë të zhvillimit të futbollit. Komiteti Ekzekutiv, po ashtu, mori vendim që të bëhet shpallja e laureatëve për vitin 2020 më 23 dhjetor në orën 17:00, ndërsa ky aktivitet do të transmetohet në TV Klan Kosova. Për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19, nuk do të ketë gala mbrëmje me mysafirë të tjerë, por të pranishëm do të jenë vetëm anëtarët e KE-s dhe laureatët e vitit 2020.

## Mjeku i Napolit: Ja e vërteta për rezultatet me Covid të Hysajt dhe Rrahmanit

NAPOLI, 16 DHJETOR - Rafaele Kanoniko, kryemjeku i skuadrës së Napolit, ka folur për atë me të cilën u përballën dy futbollistët me gjak shqiptar, Elseid Hysajt dhe Amir Rrahmanit, të cilët, pasi kishin rezultuar negativ për ndeshjen e javës së kaluar në kampionat, papritur dolën pozitive me koronavirus, përpara duelit të Ligës së Evropës. "Pse ekziston kjo diferencë në vlerësimin e tamponëve, siç ndodhi me Hysajn dhe Rrahmanin? Tashmë edhe ne mjekët e muskujve dhe terapive po bëjmë më shumë rolin e doktorëve të Covidit sesa punën për të cilën jemi të specializuar", ka thënë mjeku i Napolit. "Po flisja në mëngjes me profesor Portelën, sepse deri tani kishin ndodhur disa raste kur futbollistët, apo atletët të rëndësishëm, pasi e kishin



mposhtur një herë koronavirusin, pra ishin negativizuar, papritur janë parë sërish pozitivë, por brenda pak orësh apo ditësh sërish negativë. Kjo ndodh sepse ka një spostim celular, ndaj mund të ndodhë që gjatë një qarkulli të celulave të vdekura të

virusit të ndodhë që një tampon t'i mbledhë ato dhe në ekzaminim të rezultojë, sikur ai ka mbledhur material të rrezikshëm. Prandaj, i tillë ishte edhe rasti ynë te Napoli me Hysajn e Rrahmanin", ka deklaruar mjeku për radio "Kiss Kiss Napoli".

### SHKURT

#### Operohet Iniesta, 4 muaj jashtë fushës

Andres Iniesta është operuar për shkak të një problemi në kofshë. Një tendinë e këputur ishte problemi i mesfushorit spanjoll, që ka bërë ndërhyrjen kirurgjikale dhe do të qëndrojë katër muaj jashtë fushave të blerta. 36-vjeçari do ta humbasë fazën përgatitore dhe muajin e parë në nisje të kampionatit. Japonezët e Vissel Kobes shpresojnë që gjithçka të shkojë sipas planit dhe Iniesta të kthehet në fushën e blertë sa më shpejt. Spanjollit u dëmtua në ndeshjen e Asian Champions League, kundër Suwon Samsung. Mesfushori numëron më shumë se 60 ndeshje në kampionatin japonez dhe ka shënuar 13 gola.

#### Marco Rose mund të emërohet trajner i Dortmundit

Për momentin Borussia Dortmundi po drejtohet nga trajneri i skuadrës së të rinjve Edin Terzić, i cili nisi me një fitore ndaj Werder Bremenit aventurën si trajner i skuadrës së parë. Gjithsesi Terzić është vetëm një trajner i përkohshëm për Dortmundin që është në kërkim të një emri me peshë për ta zëvendësuar Lucien Favre. I përzgjedhuri i drejtuesve verdhezinj është Marco Rose, trajneri aktual i Borussia Moenchengladbachut që ka bërë një punë të shkëlqyer tek ekipi nga Borussia Park në këtë një vit e gjysmë, duke kaluar edhe fazën e grupeve në Ligën e Kampionëve, edhe pse u nis nga vazo e 4-t. Gjithsesi gjasat janë që Rose ta marrë në qershor drejtimin e Dortmundit, edhe pse pajtimi është arritur, pasi do të jetë e vështirë që ai të shkëputet nga Gladbach në mes të sezonit.

#### Zidane: Benzema është sulmuesi më i mirë francez

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është i kënaqur me paraqitjen e sulmuesit Karim Benzema në ndeshjen ndaj Athletic Bilbaos (3-1). Benzema në këtë ndeshje realizoi dy gola. Zidane ka thënë se sulmuesi në fjalë është sulmuesi më i mirë francez në histori. "Për mua Benzema është sulmuesi më i mirë në histori dhe këtë ai e dëshmon, më shumë se 500 ndeshje për Realin, me gola, me rekordet që flasin vetë. Për mua është më i miri. Kjo është e qartë", ka thënë Zidane.

#### WBA-ja shkarkon trajnerin Biliq

West Bromwich Albion e ka shkarkuar trajnerin Sllaven Biliq vetëm një ditë pas barazimit me Manchester Cityn në "Etihad". "West Bromwich Albion ka ndarë sot rrugët me trajnerin Sllaven Biliq. Asistentët Dean Računica dhe Danilo Buturoviq, si dhe trajneri Julian Dicks, janë larguar, po ashtu", thuhet në njoftimin e klubit. Barazimi me Cityn erdhi pas disa rezultateve të dobëta. Klubi është i 19-i në tabelën e Premier Ligës me vetëm një fitore në 13 ndeshjet e para.

#### Tenisti algjerian kurdisi ndeshje, përjashtohet përgjithmonë nga sporti

Një tenist algjerian është përjashtuar përgjithmonë nga sporti. Bëhet fjalë për 23-vjeçarin Aymen Ikhlef, që nga 11 dhjetori i këtij viti i është ndaluar të marrë pjesë në të gjithë ngjarjet sportive të tenisit Ai është akuzuar për kurdisje ndeshjesh nga "Tennis Integrity Unit", duke u bërë tenisti i tretë në pak javë që merr një dënim të tillë. Përveç përjashtimit, tenisti duhet të paguajë edhe një gjobë prej 100 mijë dollarësh. Në bazë të hetimeve, ai ka kurdisur rezultatit e katër ndeshjeve. Jo vetëm kaq, por ai ka inkurajuar lojtarët të tjerë të vendeve të ulëta në renditje që t'i kurdisin ndeshjet e tyre, duke mos dhënë maksimumin në fushë. Renditja më e mirë e Aymen Ikhlef në karrierën e tij ka qenë vendin 1739 në botë.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një veper filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti



ÇMIMI: 5.99 €

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.



4<sup>99</sup> €

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

**SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)**

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Selection of an individual consultant for Judicial and Open Data Consultant (short-term)
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2020/017
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo
Publication Date	16 December 2020
Submission Deadline	28 December 2020; 11:00 am (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for Judicial and Open Data Consultant (short-term replacement for maternity leave).

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website ([www.mcc.gov/ppg](http://www.mcc.gov/ppg)). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/selection-of-an-individual-consultant-for-judicial-and-open-data-consultant-short-term>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **28 December 2020 at 11:00 am (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

<b>The address referred to above is:</b>	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="http://www.millenniumkosovo.org">www.millenniumkosovo.org</a>



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
 për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 4076/20 të datës 11.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
 Suzana.goranci@rks-gov.net  
 Telefon: + 381 38 200 32 553

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Kupoblejna” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811369314 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kupoblejna” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811369314, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Kupoblejna” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811369314 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adil Gurgusha shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Nehat Dana shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jeton Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Majlinda Kajdomqaj shpall të pavlefshme dëftesat e jI VI - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

► Hysen Rama shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.E.J. “Hoxhë Kadri Prishtinë” Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “ES TRAVEL” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik 810064056, adresa Mitrovicë, Martirët e Kombit L3 nr. 15dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ES TRAVEL” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik 810064056, adresa Mitrovicë, Martirët e Kombit L3 nr. 15 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “ES TRAVEL” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. Unik 810064056 adresa Mitrovicë, Martirët e Kombit L3 nr. 15the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

